



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**KURSE VERORE NË GREQI:
"THE 2015 OLYMPIA SUMMER ACADEMY IN POLITICS"**

"Olympia Summer Academy" (OSA) dhe Shoqata për Studime Evropiane dhe Ndërkombëtare (EISA) kanë shpallur programin e 4-rt "The 2015 Olympia Summer Academy in Politics", i cili ofron pjesëmarrje në kurset verore që do të mbahen në qytetin piktoresk bregdetar Nafplio të Greqisë, në datat 13-23 korrik 2015.

"Olympia Summer Academy" (OSA) është një institucion bashkëkohor akademik shkencor dhe kërkimor, i cili operon në rrjet të gjerë me të gjitha institucionet ndërkombëtare kërkimore dhe shkencore, si dhe me studentë të diplomuar dhe profesorë (rreth 100) nga më shumë se 30 vende të botës. Akademia ofron kurse verore përmes një programi dinamik të jetës sociale, ku lidhjet intelektuale akademike vazhdojnë edhe pas përfundimit të programit studimor.

Pjesëmarrja në kurset verore përbën një mundësi për shkëmbimin e eksperiencave arsimore ndërmjet studentëve të diplomuar, kërkuesve e rinj dhe praktikantëve.

Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të marrin pjesë në kurset verore duhet të aplikojnë për 6 (gjashtë) ciklet e studimeve, në vijim, që përfshijnë datat 13-23 korrik 2015:

- Konflikti & Dhuna politike;
- Feja & politika;
- Filozofia, Historia, dhe Sociologjia ;
- Terrorizmi & Antiterrorizmi;
- Analiza për politikat në risk;
- Nacionalizmi & Politikat Etnike,

Shpenzimet për ushqimin, akomodimin dhe programin mësimor dhe kulturor, si dhe shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësit e kursit. Në raste të veçanta, aplikantët mund të mbështeten me bursë mbi bazën e meritës

Për një informacion më të hollësishëm lidhur me mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumenteve referojuni adresës në faqen e website:

www.olympiasummeracademy.org;

Afati i fundit për aplikimin online është data: **30 Prill 2015.**

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE